



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 139 dt.27.09.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.27.09.1996, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Mbi kontrollin e ushtruar në Ndërmarrjen Komunale Banesa Nr.1 të paraqitur nga ana e Kontroll Revizionit Ekonomiko Financiar të Bashkisë dhe Kontrollit të Shtetit dhe pasi u njohën me kërkesën për dorëheqjen e ish drejtorit të Ndërmarrje Komunale Banesa Nr.1 Tiranë drejtor i Ndërmarrje Shërbimeve Komunale Banesa,

VENDOSI

1. Të miratojë kërkesën për dorëheqjen e ish drejtorit të Ndërmarrje Komunale Banesa Nr.1 Tiranë dhe drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Banesa.
2. Të shkarkohet ish Këshilli Teknik Drejtues i Ndërmarrje Komunale Banesa Nr.1.
3. Ngarkohet për zbatimin e vendimit Drejtoria Shërbimeve Publike.

KRYETARI

BESNIK PETRELA